REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET

E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr. 861/3 Prot. Tiranë, më 20. 04. 2026

V E N D I M

Nr. 210, datë 20.04 .2026

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 20.04.2026 me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Dr. Gentiana Sula	**Kryetare**
Dr. Albert Nikolla	**Anëtar**
Altin Hoxha	**Anëtar**
Gjergj Marku	**Anëtar**
Skënder Vrioni	**Anëtar**

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i "**Udhëzuesit për Publikimin e Dokumentacionit të Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Funksionimin E Platformës "Mediateka" të Aidssh"** dhe shfuqizimi i Udhëzuesit të miratuar me Vendim Autoriteti nr 553 dt 12.11.2025.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I PËRGJITHSHËM
SEK



BAZA LIGJORE: Ligji nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", i ndryshuar; Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; Ligji nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; Ligji nr. 9154/2003, "Për arkivat", i ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024; Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"- miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024;

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbledhjen e Autoritetit më _____ nga Sektori i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese, për shqyrtimin dhe miratimin e Udhëzuesit "Për përzgjedhjen, shqyrtimin, anonimizimin dhe publikimin e dokumenteve arkivore në platformën digjitale të AIDSSH "Mediateka"

V Ë R E N:

Në përmbushje të misionit të vet institucional për rritjen e transparencës, aksesit publik dhe edukimit historik në lidhje me dokumentacionin e krijuar nga ish Sigurimi i Shtetit;

-në vijim të bërjes funksionale të plaftformës "Mediateka sipas kontratës nr. 1653/20 prot dt. 30.10.2025;

-në vijim të përmirësimit dhe reflektimit të problematikave të dala nga testimi në praktikë i platformës "Mediateka";

-Vlerëson se është i nevojshëm hartimi i një Udhëzuesi të ri për të adresuar dhe plotësuar tërësinë e këtyre cështjeve, të cilat nuk janë parashikuar në Udhëzuesin e miratuar me Vendim nr. 553 dt 12.11.2025 të Autoritetit. Kjo, me qëllim garantimin e një veprimtarie më efektive, të unifikuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë kuadër, është hartuar Udhëzuesi i ri "Për përzgjedhjen, shqyrtimin, anonimizimin dhe publikimin e dokumenteve arkivore në platformën digjitale të AIDSSH "Mediateka" i cili përcakton rregullat dhe përgjegjësitë për zbatimin e kësaj procedure.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në relacionin e paraqitur nga Sektori i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese si dhe në analizën ligjore dhe funksionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Udhëzuesit për Publikimin e Dokumentacionit të Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Funksionimin e Platformës "Mediateka" të Aidssh", bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Shfuqizimin e Udhëzuesit miratuar me Vendim nr. 553 dt 12.11.2025 të AIDSSH.

3. Ngarkohen strukturat e AIDSSH për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv–Protokollit për shpërndarjen e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Dr. Gentiana Sula

Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Dr. Albert Nikolla	**Altin Hoxha**	**Gjergj Marku**	**Skënder Vrioni**

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

UDHËZUES PËR PUBLIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT DHE FUNKSIONIMIN E PLATFORMËS MEDIATEKA TË AIDSSH

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)
Tiranë, 2026

mediateka
AIDSSH

KREU I

QËLLIMI DHE FUNKSIONI I MEDIATEKËS

Neni 1

Qëllimi dhe parimet

1. Platforma "Mediateka" synon të ndërtojë një marrëdhënie të qëndrueshme midis arkivit, studiuesve dhe publikut, duke ruajtur integritetin dokumentar dhe përgjegjësinë institucionale.

2. Publikimi i dokumenteve në Mediatekë bëhet duke ruajtur parimet e veprimtarisë së ligjit nr. 45/2015.

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij udhëzuesi është procedura e publikimit dhe përdorimit publik të njësive arkivore dhe materialeve shoqëruese në platformën Mediateka e AIDSSH-së, duke garantuar akses publik të strukturuar, të verifikueshëm dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 3
Baza ligjore

Ky udhëzues hartohet në përputhje me ligjet: nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", i ndryshuar; nenet 36, 37, 38; të ligjit 45/2015, neni 43 të ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; nenit 22, pikat 4, 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; nenit 60 shkronja "ç" të ligjit nr. 9154/2003 "Për arkivat", i ndryshuar"; ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar; rezolutën e Kuvendit datë 6.11.202; Strategjinë Afatmesme 2023–2028 të AIDSSH dhe duke u mbështetur në praktikat më të mira evropiane për menaxhimin dhe publikimin e arkivave të shërbimeve represive, përfshirë modelet e zhvilluara nga arkivat e ish-Stassi-t në Gjermani.

Neni 4
Mediateka, përkufizime

1. "Mediateka" është platforma elektronike publike e AIDSSH-së, e ndërtuar për të mundësuar paraqitjen e strukturuar të fondeve arkivore, inventarëve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe njësive arkivore të përzgjedhura nëpërmjet navigimit tematik, lidhjes me metadata të zgjeruara, transkriptove dhe materialeve audio-vizuale e dëshmive të gjalla.

2. Platforma elektronike funksionon si mjet informimi dhe kërkimi, duke ofruar ndërfaqe të qarta, kërkim të strukturuar dhe lidhje ndërmjet arkivit dhe përmbajtjeve shpjeguese.

3. Për përkufizimet e tjera shih aneksin 1.

KREU II
PËRMBAJTJA E PLATFORMËS MEDIATEKA

Neni 5
Përmbajtja

1. Platforma "Mediateka" përmban:

- strukturën e fondeve arkivore;
- inventarët e dokumenteve të deklasifikuara ose ato që deklasifikohen në vijimësi;
- njësi arkivore të shkëputura dhe të përshkruara sipas rubrikave;
- kontribute të tjera në formë dokumentare, foto, video-audio, publikime, nga subjektet e parashikuara në nenin 9 të këtij udhëzuesi.

2. Inventarët shërbejnë si mjet orientimi për publikun e interesuar dhe publikohen pavarësisht nga përzgjedhja e dokumenteve të publikuara për Mediatekë.

3. Njësitë arkivore që publikohen pjesërisht ose plotësisht në Mediatekë lidhen drejtpërdrejt me inventarët arkivorë përkatës përmes lidhjeve elektronike *(hyperlink),* duke ruajtur dallimin ndërmjet arkivit si burim primar dhe Mediatekës si platformë shpjeguese dhe ndërmjetësuese.

4. Çdo njësi arkivore shoqërohet me metadata, i cili synon të orientojë përdoruesin dhe të shpjegojë përmbajtjen pa e zëvendësuar atë.

5. Metadatat janë përshkuar në aneksin 2.

KREU III

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE PUBLIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT NË MEDIATEKË

Neni 6

1. Publikimi i njësive arkivore në Mediatekë bëhet për shkak të domethënies së tyre historike, përfaqësimit të praktikave institucionale apo aftësisë për të ndihmuar në kuptimin e mekanizmave të aparatit shtetëror të periudhës.

2. Publikimi bëhet bazuar në kërkesat nga strukturat e brendshme të AIDSSH-së, si dhe nga subjekte/individë të jashtëm sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij udhëzuesi, lidhur me persona, ngjarje apo vende historike. Struktura përgjegjëse për Mediatekën gjithashtu kërkon bazuar në kalendarin e kujtesës.

3. Kërkesat trajtohen sipas procedurave të vendosura në udhëzuesin për studiues/media.

4. Sektori përgjegjës për Mediatekën paraqet kërkesën për legjitimim pranë organit kolegjial. Pas legjitimimit, bëhet kërkimi arkivor nga ana e Drejtorisë së Arkivit. Dokumentacioni i dalë nga arkivi shqyrtohet nga sektori përgjegjës i cili kur del e nevojshme, bëhen lejet/njoftimet tek të prekurit/familjarët. Njësitë arkivore të përzgjedhura dhe të shoqëruara me metadata dhe të dhëna të tjera propozohen pranë organit kolegjial për publikim në platformën "Mediateka".

Neni 7

Roli i organit kolegjial

1. Vendimet për publikime të njësive arkivore apo kontributeve si dhe pasurimin e kalendarit merret nga Organi Kolegjial i AIDSSH.

2. Organi Kolegjial si strukturë vendimmarrëse përgjegjëse garanton ligjshmërinë, objektivitetin, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në procesin e përzgjedhjes, kërkimit, shqyrtimit dhe publikimit të dokumenteve, personave dhe ngjarjeve dhe vendeve historike.

3. Në ushtrim të këtij roli, Organi Kolegjial:

a) Shqyrton dhe miraton kërkesat për nisjen e kërkimit arkivor, duke vlerësuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik;

b) Vlerëson përmbajtjen e materialeve të përzgjedhura dhe vendos mbi formën, mënyrën dhe afatin e publikimit të tyre;

c) Garanton respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, informacionin e klasifikuar dhe të drejtën për privatësi;

d) Vendos:

- miratim të plotë ose të pjesshëm, me kufizime, redaktime apo anonimizim.
- shtyrje të vendimmarrjes për rishqyrtim dhe plotësim informacioni.
- kthim për korrigjim ose plotësim të kërkesës.
- refuzim të arsyetuar, në rast shkeljesh ligjore ose cenimi të të drejtave.
- vendosje kushtesh të posaçme për përdorimin, përpunimin, ruajtjen dhe publikimin e dokumenteve.

e) Miraton lidhjen arkiv Mediatekë,

f) Miraton publikimin në platformën Mediateka të artikujve shkencorë, studimeve dhe punimeve analitike të realizuara nga studiues, gazetarë dhe subjekte të tjera sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij udhëzuesi, që kanë pasur ose do të kenë si objekt dokumentacionin arkivor të Sigurimit të Shtetit të administruar nga AIDSSH.

Neni 8

Publikimi

1. Njësitë dokumentare publikohen pas miratimit nga organi kolegjial, të anonimizuara.

2. Në këtë fazë paraqitet edhe miratimi apo kundërshtia e palës së prekur, ose njoftimi i familjarëve, në rastet kur evidentohet që personat e prekur janë gjallë ose kanë më pak se 10 vjet që kanë vdekur, në përputhje të shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 36, sipas aneksit 3.

3. Dokumentet e miratuara publikohen në platformë me *watermark* "AIDSSH" duke garantuar akses dhe citim korrekt të burimit.

KREU IV

KONTRIBUTET NË PLATFORMËN MEDIATEKA-AIDSSH

Neni 9
Kontributet në Mediatekë

1. Platforma "Mediateka" krijon hapësirë për pranimin e kontributeve nga persona të prekur nga diktatura, familjarë të tyre, studiues, gazetarë, si dhe nga strukturat e brendshme të AIDSSH, sipas formularit (aneksi nr. 4) dhe thirrjes në web, (aneksi nr.5)

2. Me qellim informimin/edukimin qytetar, kontributet e ofruara nga subjektet e përmendura në pikën 1 mund të jenë:

a) produkte të studimit/shqyrtimit të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit në AIDSSH;

b) metadata: përshkrime kontekstuale, transkriptime;

c) propozime dokumentesh arkivore, saktësime dokumentesh;

d) dëshmi personale ose familjare.

Kontributet si më sipër mund të jenë në formë audio, video, tekst ose fotografi.

3. Publikimi bëhet vetëm me pëlqimin e shprehur të personit që jep kontributin (sipas formularit aneks 4).

Neni 10

Redaktimi dhe publikimi

1. Çdo kontribut i paraqitur i nënshtrohet procesit shqyrtimi dhe verifikimi nga sektori përgjegjës dhe/ose personat e ngarkuar nga titullari i AIDSSH-së.

2. Vendimi për publikimin, ndryshimin ose mosmiratimin e materialit merret nga Organi Kolegjial në AIDSSH, në përputhje me politikat institucionale dhe legjislacionin në fuqi.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Zbatimi

Ky udhëzues zbatohet nga të gjitha strukturat e AIDSSH-së dhe shërben si dokument orientues për funksionimin e Mediatekës dhe publikimin e arkivit.

Neni 12

Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzuesi, janë edhe anekse 1-6.

Neni 13
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzuesi, shfuqizohet udhëzuesi miratuar me vendim Autoriteti nr. 553 datë 12.11.2025.

Neni 14

Ky udhëzues hyn në fuqi menjëherë.

TABELA E ANEKSEVE

Aneksi 1: Përkufizime
Aneksi 2: Metadata
Aneksi 3: Marrja e pëlqimit/njoftimet
Aneksi 4: Formular për kontribuesit
Aneksi 5 : Kontributi për Meditekën, thirrja në web
Aneksi 6: Workflow (gjurma)

ANEKSI 1

Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzuesi, përkufizimet dhe shkurtimet kanë këto kuptime:

1. **"Anonimizimi"** është procesi i fshirjes në mënyrë të pakthyeshme i të dhënave personale dhe sensitive në përputhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive për palën e prekur dhe palët e treta.

2. **"Autoriteti"** është Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, organ kolegjial me kompetencat dhe përgjegjësitë sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe që organizohet e funksionon sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit.

3. **"DA"** është Drejtoria e Arkivit pranë AIDSSH-së.

4. **"DTIDS"** është Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Digjitaliimit dhe Sigurisë.

5. **"Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit"** janë: a) të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, veçanërisht, por pa u kufizuar: i) dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera; ii) riprodhimet, kopjimet e tyre dhe dublikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore; si dhe iii) mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave; b) dokumentet e gjykatave dhe të prokurorive, për aq sa disponon fondi i ish-Sigurimit të Shtetit; c) dokumente të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji.

"Metadata" janë të dhëna përshkruese dhe strukturore me qëllim identifikimin, përshkrimin dhe lidhjen logjike të përmbajtjes në platformë.

6. **"E dhënë personale"**, sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash;

7. "Person historik", në kuptim të këtij udhëzuesi, i referohet çdo individi, dhe/ose funksionari që ka jetuar dhe vepruar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri dhe që, përmes ideve, vendimeve ose veprimeve të tij, ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimet politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendit. Këtu përfshihen si personat që kanë bërë rezistencë ndaj regjimit dhe kanë kontribuar në përpjekjet për ndryshim, ashtu edhe ata që kanë qenë pjesë e strukturave shtetërore apo drejtuese, vendimet dhe veprimet e të cilëve kanë çuar në pasoja si represioni, persekutimi, dhuna apo varfëria.

8. **Ngjarje historike**, në kuptim të këtij udhëzuesi janë ato ngjarje të periudhës nëntor 1944-2 korrik 1991 që kanë shënjuar procesin komunist ose përpjekjen për rezistencë apo për përmbysje të regjimit

9. **Vende historike**, janë vende që kanë rëndësi të veçantë për shkak të ngjarjeve, personave ose periudhave historike që lidhen me to.

10. **Njësi arkivore** është një dokument i vetëm, i përbërë nga një ose disa faqe, që regjistrohet dhe identifikohet si një njësi e vetme në sistemin arkivor.

11. **"Organ Kolegjial"**, ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 dhe ligjit nr. 45/2015: do të quhen të gjitha ato subjekte të së drejtës publike të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekzekutive vendimarrëse në mënyrë kolegjiale.

12. **"Përpunim"** i të dhënave personale, ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024: është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

13. **"Siguria kombëtare"**, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për informacionin e klasifikuar, është mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues, jetës dhe mirëqenies së qytetarëve, pasurisë kombëtare dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë.

14. "**Subjekt i të dhënave"** është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

15. **"Të dhëna sensitive"**, sipas ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024, janë kategori të veçanta të të dhënave personale, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi.

16. **"Të dhëna të anonimizuara"** janë të dhëna, të cilat kanë qenë fillimisht të dhëna personale, por janë përpunuar në mënyrë të tillë që nuk është më e mundur që një person fizik ose juridik t'ia atribuojë këto të dhëna një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.

Aneks 2

METADATAT

Me qëllim organizimin, klasifikimin dhe kërkueshmërinë e përmbajtjeve të publikuara në platformën digjitale të AIDSSH, çdo njësi përmbajtjeje arkivore, dokumentare apo multimediale duhet të shoqërohet me metadata.

Metadatat përbëhen nga të dhëna strukturore (pema arkivore) që shërbejnë për të identifikuar, përshkruar dhe lidhur logjikisht përmbajtjet në platformë, sipas strukturës së mëposhtme (por nuk kufizohet në):

- Fondi - Emërtimi i plotë i fondit arkivor;
- Përshkrimi- përshkrim i dokumentit;
- Viti-i krijimit të dokumentit, data e krimijit original, botimit nëse është rasti;
- Struktura-Institucioni/ struktura/ individi përgjegjës për krijimin e dokumentit;
- Kutia - Nr. i arkës ku administrohet dokumenti;
- Dosar- përshkrim i dosarit ku administrohet dosja;
- Sasia e dosjeve në dosar;
- Dosja - Nr. i dosjes ku administrohet dokumenti arkivor ;
- Tipologjia e dosjes: Administrative, hetimore-gjyqësore, formulare/ përpunimi, agjenturale, personale, O.R.V, drejtimi, objekti, pune, problemi të centralizuar etj.);
- Sasia e fletëve në dosje;
- Vitet ekstreme-vitit i fillimit, viti i mbarimit;
- Hapësira gjeografike e veprimtarisë;
- **Lidhja** – Lidhjet logjike me dokumentte të tjera të publikuara në platformë;
- **Gjuha**- gjuha origjinale në të cilën është hartuar dokumenti;
- Fusha "Kontributori" përdoret për të identifikuar personat ose njësitë që kanë kontribuar në përgatitjen e përmbajtjes.

    - Për kontribues të jashtëm, lejohet shfaqja e emrit dhe mbiemrit në platformë.
    - Për punonjësit e institucionit, nuk rekomandohet përdorimi i emrave individualë. Në këto raste, kontributi duhet të paraqitet në mënyrë institucionale, duke përdorur emrin e institucionit, **AIDSSH**.

Ky standard synon të sigurojë konsistencë dhe përfaqësim të unifikuar institucional në platformë.

- Burimi-burimi i fotos, videos, materialit, etj.
- Gjëndja- (fond arkivor i hapur, i klasfifikuar)
- Niveli i klasifikimit
- Mënyra e ruajtjes: (dokumente origjinale, të digjtalizuar, mikrofilm)

Këto metadata përbëjnë bazën standarde të përshkrimit të çdo të dhëne të publikuar dhe duhet të plotësohen në momentin e hedhjes së përmbajtjes në sistem, nga përdoruesit me të drejta përkatëse.

Metadatat përbëjnë gjithashtu element kyç për kërkimin, ndërlidhjen ndër-dokumentare dhe ndihmojnë në ofrimin e një përvoje të strukturuar dhe të kuptueshme për përdoruesin.

Ato duhet të jenë të ruajtura në mënyrë të pandryshueshme në bazën e të dhënave, duke respektuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të burimeve digjitale dhe arkivore.

Përditësimi apo modifikimi i metadatave lejohet vetëm nga përdorues të autorizuar me rol specifik, pas verifikimit të domosdoshmërisë për korrektim apo pasurim informativ.

Aneksi 3

MARRJA E PËLQIMIT/NJOFTIM
(për personat e prekur/familjarët/kleri)

Drejtuar: .....

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (në vijim AIDSSH) është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar (në vijim ligji nr. 45/2015, datë 30.04.2015).
AIDSSH-ja mbledh, administron, përpunon dhe përdor dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informon në lidhje me to, sipas ligjit.
AIDSSH-ja, krahas ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015, zbaton edhe legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në zbatim të nenit 36, pika 4 e ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015, të ndryshuar *"Autoriteti, kur kjo është e mundur, vë në dijeni personat e prekur për vënien në dispozicion të të dhënave dhe merr në konsideratë kundërshtimet e mundshme të tyre, duke vlerësuar, për çdo rast, interesin privat kundrejt atij publik"*.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit po shqyrton publikimin në platformën digjitale "Mediateka" të një materiali që lidhet me personin tuaj SI palë e prekur/familjarin/klerin.
Ky publikim synon të kontribuojë në edukimin historik, transparencën publike dhe ruajtjen e kujtesës kolektive, në përputhje me ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Dokumentet përmbajnë të dhëna personale për ju në cilësinë e palës së prekur (përshkrim i shkurtër mbi cilësinë e personit)/familjarin tuaj/klerin.
Në bazë të paragrafit 4 të nenit 36 të ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015, i ndryshuar, ju keni të drejtë të paraqisni kundërshtimet tuaja/argumente nëse nga vënia në dispozicion e të dhënave dëmtohen interesat tuaja të ligjshme. (paragraf vetëm për palën e prekur dhe klerin)
AIDSSH-ja do të vlerësojë parashtrimet tuaja në përputhje me ligjin.

MARRJE NJOFTIMI

Unë, z./znj....., deklaroj se:

U njoftova nga AIDSSH-ja mbi kërkesën për publikim të paraqitur nga.... më datë.... dhe se dokumentet/duplikatat përmbajnë të dhëna për mua në cilësinë e familjarit/klerit.

Nënshkrimi_____
Datë_____

DEKLARATË MIRATIMI

Unë, z./znj....., deklaroj se:

1. U njoftova nga AIDSSH-ja mbi kërkesën për publikim të paraqitur nga.... më datë.... dhe se dokumentet/duplikatat përmbajnë të dhëna për mua në cilësinë e palës së prekur/familjarit/klerit.

2. Kuptoj se me nënshkrimin e kësaj deklarate miratoj lejimin e shqyrtimit dhe përdorimit nga të informacionit, si dhe publikimin e dokumenteve që përmbajnë të dhëna edhe për mua në cilësinë e palës së prekur, për qëllime të nenit 36 të ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015 dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nënshkrimi_____
Datë_____

DEKLARATË
SAKTËSIM/PLOTËSIM TË DHËNASH DHE MIRATIM

Unë, z./znj....., deklaroj se:

1. U njoftova nga AIDSSH-ja mbi kërkesën për informim të paraqitur nga.... më datë.... dhe se dokumentet/dublikatat përmbajnë të dhëna për mua në cilësinë e palës së prekur/palës së tretë/familjarit/institucionit fetar.

2. Parashtroj se krahas të dhënave në përmbajtje të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për të cilat jam vënë në dijeni, duhet të viheni në dijeni edhe mbi sa më poshtë:
   _____
   _____

3. Kuptoj se me nënshkrimin e kësaj deklarate miratoj publikimin e përdorimin e informacionit, së bashku me të dhënat për mua si palë e prekur për qëllime të nenit 36 të ligjit nr. 45/2015, datë 30.04.2015, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke i bashkëngjitur/konsideruar edhe parashtrimet e mia sipas pikës 2 më lart.

Nënshkrimi_____
Datë_____

DEKLARATË
REFUZIM MIRATIMI

Unë, z./znj....., deklaroj se:

1. U njoftova nga AIDSSH-ja mbi kërkesën për publikim të paraqitur nga.... më datë.... dhe se dokumentet/dublikatat, krahas informacioneve personale mbi kërkuesin, përmbajnë edhe të dhëna për mua në cilësinë e palës së prekur.

2. Refuzoj lejimin e publikimit të dokumenteve dhe informacioneve me të dhënat për mua si palë e prekur.

3. Parashtroj se nga përdorimi dhe publikimi i të dhënave dëmtohen interesat e mia të ligjshme si vijon:

_____

Nënshkrimi_____
Datë_____

Aneks 4

Formulari për kontribuesin (Sipas nenit 9 të Udhëzuesit)

"Ky formular përdoret për të kontribuar me informacion, materiale apo dëshmi që pasurojnë përmbajtjen e Platformës "Mediateka"

1. TË DHËNA PËR KONTRIBUTUESIN

Emër dhe mbiemër:_____
Roli:

- ☐ Studiues / gazetar
- ☐ Person i prekur / familjar
- ☐ Punonjës i AIDSSH

Institucioni / sektori (nëse ka):
[ ]
Kontakt (email / tel): _____

2. OBJEKTI I KONTRIBUTIT

☐ Ngjarje --
☐ Person
☐ Dokument
☐ Vend (Spaç, Qafë-Bar, etj.)
Titulli / emri: _____

3. LLOJI I KONTRIBUTIT

☐ Metadata shtesë
☐ Përshkrim / kontekst
☐ Propozim dokumenti
☐ Transkriptim / saktësim
☐ Dëshmi personale

4. PËRSHKRIM I SHKURTËR

(deri në 200–300 fjalë)
[tekst]

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

5. BURIMI

☐ Arkiv i AIDSSH

☐ Dëshmi (burim personal)

☐ Publikime

☐ Të tjera

_____
_____
_____
_____
_____

6. ÇËSHTJE TË ETIKËS

☐ Përmban të dhëna sensitive

☐ Përfshin persona ende gjallë

☐ Nuk jam në dijeni për kufizime etike

7. DEKLARATË DHE PËLQIM

☐ Deklaroj se informacioni është i saktë sipas dijenisë sime.

☐ Pranoj që materiali të verifikohet, redaktohet dhe, nëse miratohet, të publikohet nga AIDSSH

Data:
[ ]
Nënshkrimi:
[ ]

8. PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM (nga punonjës të AIDSSH)

Statusi:

☐ *Në proces*

☐ *Miratuar*

☐ *Publikuar*

Aneksi 5

PËR KONTRIBUTIN NË MEDIATEKËN E AIDSSH

(për t' u përfshirë në "homepage" të platformës)

Mediateka e AIDSSH është një platformë publike dokumentare që synon të pasurojë njohjen dhe studimin e së kaluarës përmes dokumenteve arkivore, metadata të strukturuara dhe dëshmive personale.

Kontributet nga studiues, dhe persona të prekur nga diktatura, *të cilët kanë aplikuar pranë AIDSSH dhe disponojnë dokumentacionin përkatës, j*anë të mirëpritur dhe trajtohen në mënyrë të strukturuar, të verifikueshme dhe me përgjegjësi institucionale.

KUSH MUND TË KONTRIBUOJË

a) Studiues dhe gazetarë/media

b) Arkivistë të AIDSSH

c) Persona të prekur nga diktatura

d) Familjarë të personave të prekur

e) Punonjës të AIDSSH

të cilët janë njohur dhe disponojnë dokumentacion të AIDSSH

Kontributi nuk kërkon domosdoshmërisht përvojë akademike, por duhet të bazohet në fakte, burime ose përvojë personale.

ÇFARË MUND TË KONTRIBUONI

Ju mund të kontribuoni me:

- Informacion shtesë (metadata) mbi:
  - persona të prekur
  - zyrtarë dhe struktura të kohës
  - vende dhe institucione
- Përshkrime kontekstuale për dokumente, ngjarje ose personazhe

- Propozime dokumentesh arkivore për publikim
- Transkriptime ose saktësime dokumentesh
- Dëshmi personale ose familjare (audio, video, tekst)
- Referenca bibliografike ose burime arkivore

SI TRAJTOHET KONTRIBUTI JUAJ?

Çdo kontribut:

a) regjistrohet dhe shqyrtohet nga ekipi i Mediatekës

b) verifikohet

c) publikohet vetëm pas miratimit institucional nga Organi Kolegjial

d) mund të redaktohet për qartësi, neutralitet dhe mbrojtje ligjore

Kontributi nuk publikohet automatikisht dhe nuk përbën deklarim zyrtar të AIDSSH pa përfunduar procesin e verifikimit nga sektori përgjegjës për Mediatekën dhe procesin e miratimit nga organi kolegjial.

DËSHMITË PERSONALE

Nëse dëshironi të ndani një dëshmi personale ose familjare:

a) dëshmia trajtohet me kujdes dhe respekt

b) ju informoheni për mënyrën e përdorimit dhe publikimit

c) ruhet konteksti dhe integriteti i përvojës suaj

Publikimi i dëshmisë bëhet vetëm me pëlqimin tuaj të shprehur.

SI TË DËRGONI KONTRIBUTIN

Kontributet dorëzohen përmes:

a) formularit online të Mediatekës

b) ose kontaktit zyrtar të AIDSSH

Ekipi i Mediatekës mund t'ju kontaktojë për sqarime ose plotësime shtesë.

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA

Mediateka:

a) respekton të dhënat personale

b) ruan ndarjen midis dokumentit, kontekstit dhe dëshmisë

c) citon kontributin tuaj kur kjo është e përshtatshme dhe e miratuar

FALËNDERIM

Kontributi juaj ndihmon në dokumentimin e historisë dhe ruajtjen e kujtesës kolektive. Faleminderit për angazhimin dhe besimin tuaj.

THIRRJE PËR KONTRIBUTE NË MEDIATEKË

(për t' u përfshirë në "homepage" të platformës)

Mediateka e AIDSSH mirëpret kontribute nga studiues, gazetarë persona të prekur nga diktatura dhe familjarët e tyre.

Ju mund të ndihmoni duke:

a) shtuar metadata (persona, struktura, vende)

b) propozuar dokumente arkivore

c) ofruar kontekst historik

d) kontribuar me dëshmi personale ose familjare


Çdo kontribut shqyrtohet, verifikohet dhe publikohet vetëm pas miratimit institucional.


☞ **Dërgoni kontributin tuaj përmes formularit online.**

Aneks 6

DIAGRAM GRAFIK i kontributit te jashtëm –

WORKFLOW MEDIATEKA AIDSSH




(persona, zyrtarë,
struktura, vende)
MIRATIM PËRFUNDIMTAR
(përgjegjësi instit.)
PUBLIKIM NË MEDIATEKË
(dok., metadata,
transkriptim, dëshmi)
VERSIONIM & PËRDITËSIM
(kontribute të reja)

WORKFLOW I MEDIATEKËS SË AIDSSH

Algoritëm institucional për publikimin e arkivës së ish-Sigurimit të Shtetit

